

Etika publike

Bërja transparente e prokurimit publik në nivele lokale dhe rajonale

Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale
të Këshillit të Evropës

The Congress



Le Congrès

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bërja transparente e prokurimit publik në nivele lokale dhe rajonale

Komiteti për Qeverisje

Raportuesja :¹

Amelie TARSchYS INGRE, Suedi (L, ILDG)

¹ L: Dhoma e Autoriteteve Lokale / R: Dhoma e Rajoneve
EPP/CCE: Grupi i partive popullore evropiane në Kongres
SOC: Grupi socialist
ILDG: Grupi i pavarur dhe i liberal demokratëve
ECR: Grupi i konservatorëve dhe reformatorëve evropianë
NR: Anëtarë që nuk i përkasin asnjë grupi politik të Kongresit

Përmbajtja

Përmbledhje	5
REZOLUTA 421 (2017)	6
REKOMANDIMI 405 (2017)	11
MEMORANDUM SHPJEGUES	15
Hyrje	16
1. Korrupsioni në procesin e prokurimit	20
2. Dëshmia dhe matja	22
3. Korrupsioni në prokurimin e infrastrukturës	28
4. Rreziqet sistemike	31
5 .Rekomandimet e politikave	38
6. Referenca	47

Përmbledhje

Meqenëse prokurimi publik përfshin një pjesë të madhe të shpenzimeve publike dhe, në një masë në rritje, transferimin e burimeve publike tek sektori privat ose tek organizatat jofitimprurëse, ai është veçanërisht i ndjeshëm ndaj llojeve të ndryshme të korrupsionit. Ky raport ekzaminon problemet sistemike në prokurimet e qeverive lokale dhe rajonale të cilat krijojnë rreziqe korrupsioni, të tilla si ekspertizë e dobët kontraktuese, fenomeni i "dyerve rrotulluese", ose mungesa e transparencës, dhe sugjeron hapa praktikë që autoritetet lokale dhe rajonale mund të ndërmarrin për të zvogëluar ekspozimin e tyre ndaj një korrupsioni të tillë.

Në rezolutën e tij, Kongresi fton autoritetet lokale dhe rajonale t'i vlerësojnë rreziqet e ndryshme të korrupsionit të përfshira në prokurim dhe të vendosin kontrolle të brendshme dhe mekanizma vlerësimi. Ai u bën thirrje atyre të rrisin transparencën duke publikuar të dhëna dhe detaje të prokurimit në të gjitha fazat e procesit, në mënyrë që të inkurajojnë shqyrtimin publik dhe të përfshijnë shoqërinë civile.

Në rekomandimin e tij, ai gjithashtu i kërkon Komitetit të Ministrave të inkurajojë qeveritë dhe parlamentet e shteteve anëtare të caktojnë standarde kombëtare të prokurimit publik dhe të fusin në përdorim sisteme të e-prokurimit për të minimizuar sasinë e diskrecionit njerëzor të përfshirë.

REZOLUTA 421 (2017)²

1. Korrupsioni, në shumë forma, paraqet kërcënim të madh për qeverisjen dhe demokracinë në Evropë dhe minon besimin e qytetarëve në institucionet demokratike. Prevalenca e tij prek njëloj qytetarët, qeveritë dhe bizneset, duke rritur paparashikueshmërinë dhe duke penguar investimet e reja. Duke e pasur këtë parasysh, në sesionin e tij të 31^{-të}, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale miratoi një Udhërrëfyes aktivitetesh për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivelet lokale dhe rajonale. Ky Udhërrëfyes përfshin përgatitjen e raporteve tematike, përfshirë transparencën në prokurimin publik.

2. Meqenëse prokurimi publik është një pjesë thelbësore e ofrimit të shërbimit publik për autoritetet lokale dhe rajonale, prokurimi efikas është thelbësor për qeverisjen e mirë. Prandaj, pasi që prokurimi publik përfshin një pjesë të madhe të shpenzimeve publike dhe, në një masë në rritje, transferimin e burimeve publike tek sektori privat ose tek organizatat jofitimprurëse, ai është veçanërisht i ndjeshëm ndaj llojeve të ndryshme të korrupsionit.

² E debatuar dhe miratuar nga Kongresi më 19 tetor 2017, mbledhja e 2-të, (shih Dokumentin CG33 (2017)13final, raportuesja: Amelie TARSchYs INGRe, Suedi (L, ILDG)).

3. Korrupsioni në procesin e prokurimit merr shumë forma, përfshirë dhënien e kontratave qeveritare për miq ose kroni (cronies) politikë në kurriz të një procesi transparent dhe konkurrues ose formimin e karteleve për të manipuluar procesin e tenderimit.

4. Rritja e përdorimit të kontraktimit të jashtëm dhe partneriteteve publiko-private për të ofruar shërbime publike mund të krijojë konflikt interesi në prokurimet publike. Zyrtarët publikë ose politikanët mund të përdorin njohuritë e tyre të brendshme për planet e prokurimit, ose ndikimin e tyre mbi vendimet e prokurimit, për të përfituar miqtë, të afërmit ose aleatët e tyre që ofertojnë për kontrata. Një burim tjetër i konsiderueshëm i korrupsionit është fenomeni i dyerve rrotulluese, i cili konsiston në lëvizjet e personelit nga vendet e punës në qeveri lokale në ato në sektorin privat, shpesh në kompani të përfshira në prokurimin e qeverisë lokale. Shërbyesit civilë mund të përfitojnë nga informacioni i tyre i brendshëm ose të formojnë kontrata politikash, ndërsa janë në detyrë, në mënyrë që të përfitojnë prej tyre më vonë kur punojnë për një kontraktues privat, ose të krijojnë mundësi të tjera për veten ose miqtë.

5. Rreziqe të ndryshme përfshihen gjatë procesit të prokurimit: nga faza e vlerësimit të nevojave deri tek faza e zbatimit. Në fazën e vlerësimit të nevojave, individit mund t'i fryjë nevojat, duke ndikuar kështu në të gjithë procesin e konkurrencës, ose gabimisht të shkaktojë kosto të tepruar për furnizimet. Në fazën e dizajnit, rreziqet lidhen me hartimin e kërkesave ose detajet e paqarta të përzgjedhjes. Në fazën e dhënies, zyrtari i korruptuar mund të insistojë në dobësitë e një furnizuesi të

caktuar dhe në përparësitë e supozuara të të tjerëve. Në fund, në fazën e zbatimit, rreziqet që kanë të bëjnë me monitorimin e kontraktuesit mund të çojnë në cilësi të mangët ose në rritje të kostove, duke nënkuptuar keqpërdorim të fondeve publike.

6. Ndërsa proceset e prokurimit bëhen gjithnjë e më komplekse, autoritetet lokale mund të rrezikohen nga mungesa e ekspertizës adekuate të kontraktimit midis stafit të tyre. Kjo i vë ata në disavantazh kundrejt kompanive, të cilat shpesh kanë më shumë burime për të shpenzuar në ekspertizën ligjore. Stafi i qeverisë lokale dhe rajonale shpesh përgatitet keq për të kryer procedura komplekse të kontraktimit dhe për të monitoruar zbatimin e tyre.

7. Ekzistojnë një numër hapash praktikë që autoritetet lokale dhe rajonale mund të ndërmarrin për të zvogëluar ekspozimin ndaj korrupsionit të tillë, duke filluar me transparencën. Transparenca në të gjitha fazat e procesit të prokurimit është thelbësore për të zvogëluar rreziqet për korrupsion dhe për të rritur besimin e publikut në administratat lokale dhe rajonale.

8. Zhvendosja në sistemet e e-prokurimit është demonstruar të ketë pasur efekt të konsiderueshëm në uljen e rreziqeve për korrupsion në këtë sferë.

9. Krijimi i kodeve të mirësjelljes, siç është ndalimi i pranimit të shpërblimeve, dhuratave dhe përfitimeve të tjera, të lidhura me programet e trajnimit mbi integritetin për përfaqësuesit e zgjedhur lokalë dhe rajonalë dhe zyrtarët e emëruar gjithashtu është treguar i dobishëm në shmangien e rreziqeve të konflikteve të interesit në prokurimet publike.

10. Korrupsioni në prokurimin publik shpesh zbulohet përmes raportimit nga persona të brendshëm. Këta sinjalizues mund të përballen me hakmarrje dhe prandaj duhet të mbrohen në mënyrë adekuate.

11. Në dritën e atyre që u thanë më sipër, Kongresi fton autoritetet lokale dhe rajonale të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që të:

- a.** vlerësojnë rreziqet e ndryshme të korrupsionit të përfshira në prokurim dhe të vendosin kontrolle të brendshme dhe mekanizma vlerësimi;
- b.** rrisin transparencën duke publikuar të dhëna dhe detaje të prokurimit në të gjitha fazat e procesit, në mënyrë që të inkurajojnë vëzhgimin publik dhe të përfshijnë shoqërinë civile;
- c.** sigurojnë që kërkesat për transparencë të aplikohen edhe ndaj kontraktorëve privatë të cilët ofrojnë shërbime të kontraktuara jashtë;
- d.** thjeshtojnë procedurat për prokurimin publik në mënyrë që t'i bëjnë ato të qasshme dhe të qarta për të gjitha palët e përfshira;
- e.** fusin në përdorim sisteme të e-prokurimit për prokurimin publik, përmes të cilit njoftimet për tender dhe dokumentet e tenderit publikohen në uebsajt të qasshëm publikisht dhe tenderët dorëzohen përmes sistemeve të TI-së të ngritura për atë qëllim;
- f.** promovojnë pakte integriteti midis autoriteteve kontraktuese dhe ofertuesve, ku të dy palët bien dakord që të përmbahen nga praktikat korruptive dhe t'i nënshtrohen monitorimit nga shoqëria civile;

- g.** inkurajojnë trajnimin e zyrtarëve publikë lokalë për të kryer kontraktime komplekse dhe për të kryer funksione auditimi;
- h.** promovojnë paraqitjen e një kulture kundë- mashtrim përmes edukimit për rreziqet dhe identifikimin dhe parandalimin e mashtrimit;
- i.** përcaktojnë procedurat e raportimit të cilat sigurojnë që raportet të trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe se një person nuk mund të dëmtohet për raportimin e dyshimeve për veprime të gabuara;
- j.** aplikojnë masa mbrojtëse për të parandaluar konfliktet e interesit në procesin e prokurimit, të tilla si kodet e mirësjelljes për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e prokurimit, për të bërë të qarta standardet etike që priten prej tyre. Këto do të përfshinin, për shembull, ndalimin e pranimit të shpërblimeve, dhuratave dhe përfitimeve të tjera;
- k.** dizajnojnë programe trajnimi për zbatimin e këtyre kodeve;
- l.** marrin parasysh futjen në përdorim dhe vlerësimin e rregullt të mekanizmave ekzistues të zbatimit, të tilla si procedurat disiplinore dhe sanksionet për të përforcuar zbatimin e këtyre kodeve.

12. Kongresi vendos të marrë parasysh konsideratat dhe rekomandimet e mësipërme gjatë rishikimit të Kodit evropian të Sjelljes për integritetin politik të përfaqësuesve të zgjedhur lokalë dhe rajonalë.

REKOMANDIMI 405 (2017) ³

1. Korrupsioni, në shumë forma, paraqet kërcënim të madh për qeverisjen dhe demokracinë në Evropë dhe minon besimin e qytetarëve në institucionet demokratike. Prevalenca e tij prek njëlloj qytetarët, qeveritë dhe bizneset, duke rritur paparashikueshmërinë dhe duke penguar investimet e reja. Duke e pasur këtë parasysh, në sesionin e tij të 31^{-të}, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale miratoi një Udhërrëfyes aktivitetesh për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivelet lokale dhe rajonale. Ky Udhërrëfyes përfshin përgatitjen e raporteve tematike, përfshirë transparencën në prokurimin publik.

2. Prokurimi publik gjendet në zemër të ofrimit të shërbimeve publike për qeveritë lokale dhe rajonale. Në të njëjtën kohë ai mund të jetë veçanërisht i cenueshëm ndaj korrupsionit, pasi përfshin transferimin e burimeve publike tek sektori privat ose tek organizatat jofitimprurëse.

3. Një pjesë thelbësore e qeverisjes së mirë është sigurimi i një prokurimi të pastër dhe efikas, i cili, si një fushë e rëndësishme e shpenzimeve publike, mbart rreziqe të konsiderueshme korrupsioni.

³ Shih fusnotën 2

4. Transparenca maksimale në të gjitha fazat e ciklit të prokurimit është parimi kryesor për zvogëlimin e rreziqeve të korrupsionit në prokurim dhe për ruajtjen e besimit të publikut në administratat lokale dhe rajonale.

5. Prokurimi publik ka tendencë të jetë i cenushtëm ndaj korrupsionit, veçanërisht pasi përfshin transferimin e burimeve publike tek sektori privat ose tek organizatat jofitimprurëse.

6. Korrupsioni në procesin e prokurimit mund të marrë forma të ndryshme, të tilla si dhënia e kontratave qeveritare për miq ose kroni (cronies) politikë në kurriz të një procesi transparent dhe konkurrues, ose fenomeni i dyerve rrotulluese, ku shërbyesit civilë përfitojnë nga informacioni i tyre i brendshëm ose formësojnë kontrata politikash, ndërsa janë në detyrë, në mënyrë që të përfitojnë prej tyre më vonë kur punojnë për një kontraktues privat, ose të krijojnë mundësi të tjera për veten ose miqtë.

7. Rreziqet janë prezente në të gjitha fazat e procesit të prokurimit: në fazën e vlerësimit të nevojave, individit mund t'i fryjë nevojat, duke ndikuar kështu në të gjithë procesin e konkurrencës, ose gabimisht të shkaktojë kosto të tepruar për furnizimet. Në fazën e dizajnit rreziqet lidhen me hartimin e kërkesave ose detajet e paqarta të përzgjedhjes; në fazën e dhënies, një zyrtar i korruptuar mund të insistojë në dobësitë e një furnizuesi të caktuar dhe në përparësitë e supozuara të të tjerëve; në fazën e zbatimit, rreziqet që kanë të bëjnë me monitorimin e kontraktuesit mund të çojnë në cilësi të mangët ose në rritje të kostove, duke nënkuptuar keqpërdorim të fondeve publike.

8. Shumë autoritete lokale janë gjithashtu në rrezik për shkak të mungesës së ekspertizës kontraktuese midis stafit të tyre, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e prokurimit publik. Personeli i përfshirë në proceset e prokurimit ndonjëherë nuk ka kompetencë për të kryer procedura komplekse të kontraktimit dhe për të monitoruar zbatimin e tyre.

9. Një mjet efektiv në luftimin e korrupsionit në prokurimin publik është informacioni i siguruar nga ata që kanë njohuri të brendshme për proceset. Këta sinjalizues duhet të mbrohen. Ata përballen me një rrezik real të hakmarrjeve dhe presioneve frikësuese që mund të jenë veçanërisht shqetësuese në nivelin lokal.

10. Në dritën e këtyre konsideratave, Kongresi fton Komitetin e Ministrave të inkurajojë qeveritë dhe parlamentet e shteteve anëtare dhe, kur është e zbatueshme, rajonet me kompetenca legjislative, që të:

- a.** krijojnë standarde kombëtare në lidhje me prokurimin publik, në mënyrë që ta bëjnë procesin më transparent dhe më të lehtë për t'u kuptuar;
- b.** fusin në përdorim sisteme të e-prokurimit për të minimizuar sasinë e diskrecionit njerëzor në proces, duke përdorur norma dhe procedura të standardizuara për komunikim dhe mjete në internet;
- c.** sigurojnë transparencë maksimale në të gjitha fazat e ciklit të prokurimit duke publikuar të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të lexueshme nga makina që nga fillimi i procesit të prokurimit;
- d.** sigurojnë nivel të përbashkët trajnimi dhe/ose kualifikimi profesional për stafin përgjegjës për proceset e prokurimit;

- e.** krijojnë një grup të përbashkët treguesish në nivel kombëtar për të lehtësuar analizimin e rrezikut të favorizimit në proceset e prokurimit;
- f.** krijojnë një organ të pavarur për të hetuar ankesat;
- g.** rregullojnë dhe ndjekin lëvizjet e punësimit nga sektori publik në atë privat për të ulur rrezikun e konflikteve të interesit përmes procesit të “dyerve rrotulluese”;
- h.** ngrisin një linjë telefonike anonime për sinjalizues për të lehtësuar raportimin për shpërdorim dhe për të siguruar mbrojtjen e atyre që raportojnë informacion të tillë.

MEMORANDUM SHPJEGUES⁴

⁴ Raporti i përgatitur nga Dr Elizabeth David-Barrett, Universiteti i Sussex, 1 mars 2017

Hyrje

1. Prokurimi publik përbën mesatarisht 29% të shpenzimeve totale të qeverisë në vendet e OBZHE-së, megjithëse pjesa e shpenzuar nga autoritetet lokale dhe rajonale në krahasim me qeverinë qendrore ose ndërmarrjet shtetërore varion shumë mes shteteve. Ai përfshin shpenzime për projekte të mëdha, të tilla si infrastruktura e re, si dhe prokurime të përditshme të nevojave të vazhdueshme, nga mirëmbajtja e rrugëve deri tek pajisjet e zyrave.

2. Korrupsioni përcaktohet si abuzim me pushtetin e besuar (Transparency International). Korrupsioni politik ndodh kur një mbajtës funksioni publik thyen rregullat që lidhen me punën e tij ose të saj në atë mënyrë që përfiton një kompani ose kroni (crony) dhe nxitet ta bëjë këtë përmes premtimit për përfitime personale ose partiake. Shkëmbimi mund të iniciohet nga mbajtësi i funksionit publik ose nga kompania.

3. Korrupsioni mund të jetë tepër oportunist, d.m.th., veprime të njëhershme për përfitime personale ose nepotike; ose sistemik, p.sh., i organizuar nga një parti ose elitë politike si mënyrë për financimin e aktiviteteve politike dhe ngritjen e mbështetësve besnikë (si në klientelizëm), si dhe për përfitime më private. Zakonisht, niveli i korrupsionit varet nga:

- ▶ *mundësitë* në dispozicion të mbajtësve të funksioneve publike, d.m.th., sa pushtet dhe diskrecion kanë për të kontrolluar proceset; dhe

- niveli i *llogaridhënies* që e kufizon pushtetin e tyre - d.m.th., shkalla në të cilën të tjerët kanë pushtet të shqyrtojnë vendimet dhe veprimet e tyre dhe t'i mbajnë ato nën kontroll(Mungiu-Pippidi, 2006).

4. Prokurimi publik është shumë i cenueshëm ndaj korrupsionit politik. Kjo pasqyron faktin se, nga natyra e tij, prokurimi publik përfshin transferimin e burimeve shtetërore. Këto burime transferohen tek organizatat e sektorit privat ose ato jofitimprurëse (ose, herë pas here, tek agjenci të tjera shtetërore), të cilat fitojnë kontrata për ofrimin e mallrave, punëve ose shërbimeve. Qëllimi i politikës publike në prokurimin publik është të përzgjedhë ofruesin më të aftë për të ofruar mallra, punë ose shërbime me cilësi të lartë dhe të sigurojë vlerën për paratë e taksapaguesve. Sidoqoftë, procesi është shënjestër tërheqëse për individë dhe kompani që kërkojnë të shtrembërojnë procesin në mënyrë korruptive për të arritur përfitime personale ose partiake.

5. Në prokurimin publik, supozohet se rezultatet më të mira për publikun do të arrihen nëse ka konkurrencë të hapur për kontrata dhe vendimet për mënyrën e dhënies së kontratave bëhen paanësisht, në bazë të vlerës më të mirë për paratë. Kur ndodh korrupsioni në prokurimin publik, ai zakonisht përfshin masa që pengojnë konkurrencën e hapur ose japin kontrata mbi bazën e lidhjeve të veçanta - të tilla si lidhjet nepotike ose klienteliste me familjen, të afërmit ose aleatët politikë. Korrupsioni në prokurimin publik mund të përfshijë edhe ryshfet të drejtpërdrejtë.

6. Korrupsioni mund të jetë edhe privat-privat, duke mos përfshirë mbajtësit e funksioneve publike. Për shembull, kur ofertuesit formojnë kartel dhe bashkëpunojnë për të manipuluar rezultatin e një tenderi, kjo përbën një formë korrupsioni. Ndonjëherë, furnizuesit në bashkëpunim segmentojnë tregun e prokurimit për një gamë të veçantë mallrash dhe i mundësojnë secilit furnizues qasje ekskluzive në një segment specifik, p.sh., në një rajon ose lloj pajisjesh. Në raste të tjera, tenderët manipulohen në mënyrë të tillë që 'suksesi' kalon me rotacion mes anëtarëve të kartelit. Furnizuesit me radhë dorëzojnë oferta për disa vite, me furnitorët e tjerë në çdo tender duke mos dorëzuar ofertat e tyre ose duke i dorëzuar ato me çmime të fryra, në mënyrë që të shtyjnë zyrtarët publikë drejt përzgjedhjes së një oferte të veçantë. Më pas, anëtarët e kartelit mund të nënkontraktojnë njëri-tjetrin për një pjesë të punës ose të ndajnë fitimet, ose thjesht bien dakord t'ia mundësojnë një kompanie tjetër të fitojë në rastin tjetër. Kjo formë e korrupsionit nuk ka nevojë të përfshijë aktor të sektorit publik, megjithëse shpesh zyrtarët publikë marrin rryshfet për të mos marrë parasysh dëshmitë e një veprimtarie të tillë.

7. Korrupsioni në prokurimin publik ka të ngjarë të çojë në vlerë të dobët për paratë dhe rezultate nën-optimale. Ai mund të shpie edhe që grupe të caktuara politike ose shoqërore të fitojnë avantazhe të padrejta politike, duke minuar demokracinë dhe proceset e demokratizimit.

8. Korrupsioni në prokurimin publik gjithashtu shtrembëron ekonominë e tregut, pasi prania e favorizimit në dhënien e kontratave do të thotë që kompanitë jo të korruptuara e kanë të vështirë të konkurrojnë, duke penguar bizneset e reja të hy-

jnë në treg. Kjo shkakton dëmtime afatgjata në treg për mallra të veçanta, duke çuar në rritje të çmimeve dhe vlerë më të dobët për paratë.

9. Korrupsioni në prokurimin publik mund të minojë edhe besimin në qeveri dhe kjo mund të jetë veçanërisht e dëmshme në vendet në tranzicion ose në zhvillim që kërkojnë të ndërtojnë legjitimitetin e shtetit. Skandalet e përqendruara në shpërdorim në prokurimin publik janë relativisht të shpeshta dhe nganjëherë kanë çuar në rrëzimin e qeverive nga pushteti.

1. Korrupsioni në procesin e prokurimit

10. 'Cikli jetësor' i prokurimit i ka katër faza: (i) vlerësimi i nevojave; (ii) dizajnimi i tenderit; (iii) dhënia; dhe (iv) zbatimi i kontratës pas dhënies. Në secilën fazë, procesi është i cenueshëm ndaj manipulimit për qëllime korruptive.

11. Në fazën e vlerësimit të nevojave, autoriteti kontraktues e vlerëson nevojën e vet për mallra ose shërbime, merr vendim se çfarë të blejë dhe përgatit një buxhet për blerjen e planifikuar. Individët e korruptuar mund ta manipulojnë sistemin duke i fryrë në mënyrë të rreme nevojat, duke anuar qëllimisht paralogaritë e kostove ose duke bërë furnizime të tepruara gabimisht.

12. Në fazën e dizajnit, dokumentet e tenderit përgatiten, duke specifikuar kërkesat, duke përfshirë çdo kusht në lidhje me standardet e cilësisë ose sigurisë. Korrupsioni mund të ndodhë nëse kërkesat hartohen në atë mënyrë që favorizojnë ose dëmtojnë furnizues të veçantë, nëse përdoren kriteret e paqarta të përzgjedhjes dhe dhënies, ose kur thirren procedura jokonkurrese (p.sh., emergjencë e ekzagjeruar) pa justifikim të duhur.

13. Gjatë fazës së dhënies, njoftimi i prokurimit publikohet, lëshohen dokumente ofertimi dhe kërkohen propozime. Ofertuesit ia dorëzojnë propozimet e tyre zyrtarit të prokurimit, i cili më pas i vlerëson të gjitha propozimet dhe vendos për

dhënien e kontratës. Zyrtarët publikë mund të ndikojnë në mënyrë korruptive në proces duke hartuar kriteret vlerësimi për të favorizuar ose për të theksuar dobësitë e një furnizuesi të veçantë, duke mos dhënë njoftim adekuat publik për tenderin (duke përfituar ata me njohuri të brendshme ose ata që kanë fituar më parë kontrata të ngjashme), duke kërkuar oferta që dihet se janë inferiore ndaj një furnizuesi të favorizuar, duke pranuar propozime të vonuara ose duke refuzuar propozime legjitime, ose duke marrë vendime të njëanshme në fazën e vlerësimit. Nga ana e kompanive, ofertuesit mund të përfshihen në bashkëpunim, në mënyrë të tillë që ata të vendosin mes vete se cila kompani do ta ‘fitojë’ ofertën, dhe më pas i vendosin çmimet e tyre në përputhje me rrethanat për të siguruar suksesin e asaj kompanie të veçantë. Ata më pas e kalojnë me rotacion ‘suksesin’ mes vete sipas marrëveshjes së tyre, duke manipuluar ofertat pasuese në të njëjtën mënyrë.

14. Në fazën e zbatimit të kontratës, ofertuesi fitues duhet të sigurojë mallrat dhe shërbimet e rëna dakord, në përputhje me kushtet dhe kohën e rënë dakord në kontratë. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues - një departament qeveritar ose një komunë lokale - mban përgjegjësi për të monitoruar përmbushjen e kontratës, një aspekt i procesit që shpesh kontrollohet shumë më pak. Korrupsioni mund të ndodhë nëse nënkontraktuesit e favorizuar nuk mbahen përgjegjës ose përdorimi i mallrave nën-standard nuk merret parasysh, ose nëse një kompani e korruptuar dhe zyrtari mbikëqyrës i korruptuar bashkëpunojnë për të rënë dakord për rritjen e çmimeve ose ndryshimet në specifikimet. Megjithatë korrupsioni mund të bëhet i dukshëm vetëm gjatë kësaj faze të zbatimit të kontratës, ai mund të jetë rezultat i bashkëpunimit në një fazë më të hershme midis zyrtarëve publikë dhe kompanisë.

2. Dëshmia dhe matja

15. Identifikimi i rasteve të korrupsionit në prokurimin publik është shumë i vështirë. Kjo pjesërisht pasqyron faktin se ata që kryejnë veprime korruptive kanë interes ta mbulojnë atë, sepse është e paligjshme dhe ata mund të dënohen nëse kapen, ndërsa ata shpesh edhe kanë fuqinë t'i fshehin veprimet e tyre ose edhe t'i përmbysin përpjekjet për të bërë transparente veprimet e tyre. Sidoqoftë, më thellësisht, kjo vështirësi pasqyron natyrën komplekse të gjykimeve nëse parregullsitë e dukshme përbëjnë korrupsion e jo paaftësi ose joefikasitet.

16. Sigurisht që ka dëshmi se prokurimi publik perceptohet gjerësisht si i korruptuar. Një anketë e posaçme e Eurobarometer-it mbi qëndrimet e biznesit ndaj korrupsionit (i publikuar në vitin 2014, bazuar në hulumtimin e kryer në muajt shkurt-mars të vitit 2013) parashtrroi pyetje specifike në lidhje me perceptimin e korrupsionit në prokurimin publik nga kompanitë që bëjnë pjesë dhe nuk bëjnë pjesë në oferta për kontrata qeveritare (Eurobarometer, 2014). Nga kompanitë që kishin marrë pjesë në një procedurë të prokurimit publik në tri vitet e mëparshme, 35% menduan se korrupsioni në prokurimin rajonal/lokal ishte i përhapur. Korrupsioni në prokurimin rajonal/lokal nuk mendohej të ishte më i përhapur sesa në prokurimin e nivelit kombëtar.

17. Nga ata të anketuarit që nuk kishin marrë pjesë në prokurimin publik në tri vitet e fundit, 64% menduan se kor-

rupsioni ishte i përhapur në prokurimin publik lokal/rajonal. Ndërsa ky grup është padyshim më pak i informuar, perceptimet e tyre janë megjithatë shumë të rëndësishme, pasi vetëm perceptimi se korrupsioni është i përhapur mund të jetë i mjaftueshëm për të penguar disa kompani të ofertojnë, duke kufizuar kështu qasjen në treg dhe konkurrencën e hapur. Në tërë BE-në, 11% e kompanive thanë se kishin vendosur të mos merrnin pjesë në të paktën një tender sepse “marrëveshja dukej se ishte bërë para thirrjes për tender” (duke filluar nga një e treta e kompanive në Portugali në vetëm 1% në Danimarkë), ndërsa 16% e pjesëmarrësve nuk morën pjesë në tender sepse “kriteret dukeshin të jenë të përshtatura për pjesëmarrës të caktuar” (nga 36% në Portugali në 7% në Danimarkë).

18. Ekziston një variacion i konsiderueshëm në perceptime të korrupsionit në sektorë të ndryshëm. Ndërtimi, inxhinieria dhe elektronika ishin më të lidhurat me kontraktimin korrupsiv. Në sektorin e ndërtimit, 35% e kompanive thanë se ishin parandaluar të fitonin kontratë për shkak të korrupsionit. Shërbimet financiare, bankimi dhe investimet ishin më pak të lidhura me korrupsionin, ndonëse megjithatë, 18% e kompanive menduan se ishin parandaluar të fitonin kontratë në këto fusha për shkak të korrupsionit.

19. Kompanitë më të vogla e perceptojnë korrupsionin si më të përhapur sesa kompanitë më të mëdha: nga kompanitë me qarkullim vjetor më pak se 100,000 euro, 48% mendojnë se kanë humbur kontratë prokurimi në nivel rajonal/lokal për shkak të korrupsionit; vetëm 11% e kompanive me qarkullim prej më shumë se 50 milion euro mendojnë të njëjtën gjë. Ndërsa

perceptimet janë një tregues jo i plotë i niveleve reale të korrupsionit, është e besueshme që kompanitë më të mëdha e kanë më të lehtë të shmangin pagimin e ryshfetit, sepse ato kanë ndikim të konsiderueshëm dhe autoritetet kontraktuese mund të dëshirojnë të angazhojnë një firmë të tillë prestigjioze. Përndryshe, ndërmarrjeve më të mëdha mund t'u kërkohej të paguajnë ryshfet më rrallë, ndoshta sepse zyrtarët publikë i perceptojnë kontrollet e tyre si më të rrepta, dhe kështu mendojnë se sjellja e tyre e paligjshme ka më shumë të ngjarë të ekspozohet. Sidoqoftë, është gjithashtu e mundur që kompanitë më të vogla nuk arrijnë të fitojnë kontrata për arsye të pranueshme, por sidoqoftë e fajësojnë korrupsionin si shkak i mungesës së suksesit të tyre.

20. Perceptimet për korrupsionin variojnë shumë në të gjitha vendet, madje edhe brenda BE-së. Në Sllovaki, 84% e kompanive të anketuara thanë se praktika e specifikimeve të përshtatura për kompani të veçanta ishte e përhapur, e ngjashme me nivelet në Greqi (81%), Spanjë dhe Qipro (të dyja 80%). Kompanitë daneze kishin më pak të ngjarë të thoshin se praktika e ofertave të përshtatura ishte e përhapur (23%), e ndjekur nga ato në Mbretërinë e Bashkuar dhe Estoni (të dyja 35%).

21. Të dhëna të tilla të hollësishme të perceptimit nuk janë në dispozicion për vendet e tjera. Sidoqoftë, Raporti Global i Konkurrencës i Forumit Ekonomik Botëror parashton një pyetje se sa e zakonshme është për kompanitë që "të bëjnë pagesa shtesë të padokumentuara ose ryshfete në lidhje me dhënien e kontratave publike dhe licencave". Përgjigjet e mundshme variojnë nga 1 (shumë e zakonshme) në 7 (nuk

ndodhë kurrë). Në këtë matje, Zelanda e Re, Finlanda dhe Singapori janë vendet më pak të korruptuara, me rezultatet 6.5, 6.5 dhe 6.4 respektivisht. Vendet evropiane me rezultatin më të keq janë Hungaria (2.6), Bosnja dhe Hercegovina (2.6) dhe Ukraina (2.4). Në Afrikë, rezultatin më të mirë e mban Ruanda me 5.3, por shumica e vendeve afrikane shënojnë nën 4, kurse rezultatin më të keq e mban Nigeria (1.8). Në Azi, shumica e vendeve rezultojnë në intervalin 3-5, megjithëse Bangladeshi është i 139^{ti} nga 140 në renditje me rezultatin 1.8. Amerika Latine ka një gamë të gjerë, duke përfshirë disa nga vendet më të korruptuara, të tilla si Argjentina (1.8), e renditur në vendin e 138^{të} nga 140, dhe Venezuela (1.7), e renditur e fundit në tabelë.

22. Puna e fundit nga projekti ANTICORRP i financuar nga BE-ja ka zhvilluar një sërë treguesish të favorizimit në prokurimin publik duke u përqendruar në aspekte të caktuara të procesit (p.sh., aplikimi i tepruar i procedurave që kufizojnë konkurrencën tek ofertuesit e vetëm ose specifikimet e panevojshme shtrënguese të kërkesave) gjithashtu si rezultate (p.sh., ofertuesit fitues kanë lidhje të forta politike ose fitojnë vetëm në kombinim me ofertues të tjerë të caktuar)(Mungiu Pippidi, 2015).

23. Kjo metodologji e re për matjen e korrupsionit në prokurimin publik nuk mbështetet në anketat e perceptimeve, por në vend të kësaj përfiton nga 'të dhënat në sasi të mëdha' dhe fuqia e nivelit të lartë të përpunimit kompjuterik(Mihály Fazekas & Kocsis, 2015). Metoda analizon grupe të mëdha të dhënash të informacionit kontraktues, përfshirë informacionin në lidhje me procesin e ofertimit dhe fituesit dhe humbësit e

tenderëve. Duke analizuar këto të dhëna, është e mundur të identifikohen ‘flamuj të kuq’ të caktuar që mund të jenë tregues të korrupsionit. Analizimi i një numri të madh kontratash gjatë disa viteve dhe autoriteteve të ndryshme u mundëson studiuesve të identifikojnë modelet që lidhen me autoritete të caktuara kontraktuese ose firma të caktuara (ose kartelet). Kjo mund të informojë hetime të mëtejshme për të vërtetuar nëse modelet janë rezultat i korrupsionit ose jo. Për më tepër, analiza bazohet në të dhëna objektive, jo në perceptime, dhe kështu premtan të jetë më e besueshme.

24. Flamujt e kuq të rrezikut të mundshëm të korrupsionit në prokurim përfshijnë tenderë me afate shumë të shkurtra (të cilat kanë tendencë të përfitojnë personat e brendshëm me qasje në informacion më të shumtë), aplikim të procedurave jokonkurrese (duke hapur rrugë për favorizim), ofertues të vetëm (duke sugjeruar që kompanitë e tjera të tërhiqen nga pjesëmarrja), dhe prevalencë të lartë të kompanive shumë të reja midis ofertuesve fitues. Sidoqoftë, mund të ketë edhe arsye plotësisht të pranueshme për të gjithë këta faktorë, prandaj kërkohet një analizë e kujdesshme.

25. Kjo metodë po aplikohet për të analizuar kontraktimin në vendet e BE-së në një projekt të madh hulumtues të financuar nga BE-ja i njohur si Digiwhist, sinjalizuesi digjital. Projekti përpilon dhe vlerëson të dhëna në nivelin mikro duke përdorur informacione nga transaksionet individuale të prokurimit publik dhe strukturat e financimit dhe pronësisë së ofertuesve fitues. Këto të dhëna mund të lidhen me informacionin mbi të dhënat e përgjithshme të deklaratave të pasurisë dhe të të ardhurave në mënyrë që të zbulohen konf-

liktet e mundshme të interesit në prokurimin publik, dhe për të identifikuar dobësitë sistemike në legjislationet përkatëse dhe zbatimin e tyre (shih www.digiwhist.eu).

26. Rritja e përdorimit të kontraktimit të jashtëm dhe partneriteteve publiko-private për të ofruar shërbime publike i ka mjegulluar kufijtë tradicionalë midis sektorit publik dhe privat, të cilat mund të pengojnë llogaridhënien(OECD, 2011b). Kjo mund të krijojë konflikte të interesit, për shembull, me zyrtarë publikë ose politikanë që përdorin njohuritë e tyre të brendshme për planet e prokurimit, ose ndikimin e tyre mbi vendimet e prokurimit, për të përfituar miqtë, të afërmit ose aleatët që ofertojnë për kontrata, ose të fitojnë punë në të ardhmen për veten e tyre(David-Barrett, 2013).

3. Korrupsioni në prokurimin e infrastrukturës

27. Problemet në fazën e zbatimit të kontratës janë dokumentuar veçanërisht në rastin e prokurimit të madh infrastrukturor. Një analizë e koncesioneve infrastrukturore në Kili për një periudhë 25-vjeçare zbuloi se kontratat shpesh rinegocioheshin brenda periudhave shumë të shkurtra pas dhënies së kontratës fillestare dhe se kjo pothuajse gjithmonë çonte në rritje të kostove për autoritetet kontraktuese dhe/ose në ulje të kërkesave për investime për ofertuesit fitues (Guasch & Straub, 2009). Hulumtimi mbi parallogaritë e kostove dhe kërkesës të shoqëruara me projekte të mëdha infrastrukturore që përfshijnë 258 projekte në 20 vende mbi pesë kontinente, zbulon se nëntë nga dhjetë projekte kanë kosto të konsiderueshme të mbingarkuar (mesatarisht 44.7% në rastin e projekteve hekurudhore) dhe se aftësia jonë për të parashikuar kostot nuk është përmirësuar gjatë një periudhe 70-vjeçare (Flyvbjerg & Molloy, 2011) UK, "title": "Delusion, deception and corruption in major infrastructure projects: Causes, consequences and cures", "type": "chapter"}, "uris": ["http://www.mendeley.com/documents/?uuid=8d0ad18f-bf17-44f1-8f12-637603bb75d2"] }], "mendeley": { "formattedCitation": "(Flyvbjerg & Molloy, 2011). Në hulumtime të ngjashme mbi parashikimet për kërkesën për projekte infrastrukturore për një periudhë

30-vjeçare, ata zbulojnë se përfitimet vazhdimisht janë mbivlerësuar dhe prapëseprapë kostot janë nënvlerësuar.

